VENDIM
Nr.253, datë 12.3.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS ÇLIRIM, TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Çlirim, të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Çlirim, të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.532, datë 1.5.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Çlirim, të qarkut të Korçës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Çlirim për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Çlirim — Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1-10	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
11-21	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
22-25	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
26-37	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
26-37	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
38-49	Varrezat publike	Në pronësi
670-692	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
693,696,697,700,703, 706,710,714,715,718, 721,722,723,726,727, 728,731,732,733,737	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
694,695,698,699,701, 702,704,705,707,708, 709,711,712,713,716, 717,719,720,724,725, 729,730,734,735,736,	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi

738, 739,740		
741-746	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në zhvillimin ekonomik.	Në pronësi
747-753	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi